| 1 | Bujqësore/Poljoprivredno/Agriculture | Kullosat/Pašnjaci/pasture | Kullosë E Klasës 2/Pasnjak 2 Klase/2nd Class Pasture | 21241 |

## B. PRONARI/POSEDUESI - VLASNIK/DRŽALAC - OWNER/POSSESSOR

| Të drejtat<br>Prava<br>Rights | Emri<br>Ime<br>Name | Nr. personal<br>Licni broj<br>ID. No. | Vendbanimi<br>Prebivaliste<br>Resident | Kodi postal<br>Poštanski kod<br>Postal code | Hollësitë e adresës<br>Pojedinosti adrese<br>Address details | Pjesa e pronës<br>Deo imovine<br>Share quota | Pershkrimi<br>Opis<br>Description | Azhuruar<br>Ažurirano<br>Updated |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Posedim individual / Individualna Drzavina / single possessor | **Pronë Komunale KK Gllogoc** | KCID0307744 | POLLUZHË / POLUŽA / POLLUZHË / | | GLLOGOVC 87 | 1/1 | 0005-84 | |

Zyrtari ... Odgovorno lice / Official person

REPUBLIKA E KOSOVËS · KOMUNA GLLOGOC · REPUBLIKA KOSOVA · OPŠTINA GLLOGOC · REPUBLIC OF KOSOVO · GLLOGOC MUNICIPALITY

**Republika e Kosovës**
Republika Kosova-Republic of Kosovo
*Qeveria - Vlada - Government*

Komuna/Opstina/Municipality Drenas (Gllogoc)
Zyra e Kryetarit
01 **Nr.** 030/01-5460/**dt.** 16.12.2020

Në bazë të nenit 11,12 dhe 40 të ligjit për vetëqeverisje lokale nr.031/L-040 , nenit 72 pika 72.1 nën (h) të Statutit të Komunës së Drenasit, Ligjit 07/L-006 për Parandalimin dhe luftimin e Pandemisë COVID-19, Rregullorës nr. 12.030-19516 për Taksa, Tarifa dhe Gjoba dhe kërkesës se Shoqatës se Transportit Publik të udhëtarve me Autobus, më dt.10.12.2020 nr.13-070-53693, Kryetari komunës bjenë këtë:

**PROPOZIM-VENDIM**

**Për lirim nga pagesa e peronizimit për kompanit e transportit publik të udhëtarve me autobus për linjat urbano-periferike dhe ndërurbane që shfrytzojn stacionin e autobusve në Gllogoc, për operim.**

I

Me këtë propozim Vendim, kërkohet lirimi nga pagesa e peronizimit për kompanit e transportit publik të udhëtarve me autobus për linjat urbano-periferike dhe ndërurbane që shfyrtzojn stacionin e autobusve në Gllogoc për operim.

II

Lirimi nga pagesa e peronizimit, është në aftatin kohor prej 6 muajsh, nga miratimi i këtij Propozim –Vendimi, me mundësi vazhdimi , varësisht prej gjendjës se krijuar Pandemike nga COVID-19.

III

Për zbatimin e këtijë Vendimi, kujdeset Kryetari i komunës, Drejtoria për Buxhet e Financa dhe Drejtoria për Shërbime Publike dhe Emergjencë.

VI

Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë nga dita e regjistrimit dhe vlerësimit të ligjshmërisë nga MPL-ja, si dhe 7 ditë nga publikimi në Ëeb faqen zyrtare të Komunës

Kryetari I Komunës

Ramiz Lladrovci

ARSYETIM

Në bazë të kërkesës se Shoqatës se Transportit Publik të udhëtarve me Autobus që operojn në linjat Urbano-perfierike dhe Ndërurbane në komunën e Gllogocit, më dt.10.12.2020 nr.13-070-53693, Kryetari komunës me qëllim të lehëtsimin të kryerjes se Shërbimeve për kompanit e Transportit Publik të Udhëtarve, si dhe për shkak të zvoglimit të numrit të udhëtarve , si rezulatat I Pandemisë COVID -19, kërkoj që të mirret parasysh të gjitha këto vështersi të krijuara për kompanit Transportit me autobus të udhëtarve, dhe miratimin e këtij propozim – Vendimi.

**REPUBLIKA E KOSOVËS**
**Komuna e Drenasit**
**Zyra e Kryetarit**
**Nr** 01-400/01-55093 **Dt.** 21.12.2020

Për:z.Labinot Halilaj, Kryesues i Kuvendit të Komunës

Nga: Ramiz Lladrovci ,Kryetar i Komunës

**RAPORT I DYTË PERIODIK PËR ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE**

**të dhëna në Raportin e Auditimit nga Zyra Kombëtare e Auditimit**

| Nr. | Komp | Gjetja | Rekomandimi | Veprimet e ndërmarra dhe | Statusi i rekomandi | Sfidat e hasura |
|---|---|---|---|---|---|---|

| | one nta | | | rezultatet konkrete në lidhje me zbatimin e rekomandimit | mit( i zbatuar, pjesërisht i zbatuar ose i pa zbatuar) | në zbatimin e rekomandimit |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | B 1 | **-Keq klasifikimi i shpenzimeve.**<br>*Siç kemi paraqitur te theksimi i çështjes, komuna ka paguar shpenzime për paga dhe mëditje në vlerë 551,242€ nga kategoritë ekonomike jo adekuate. Nga mallrat dhe shërbimet ishin paguar 246,119€, nga subvencionet 16,868€ si dhe nga investimet kapitale 288,255 €. Këto pagesa janë kryer nga Thesari në bazë të vendimeve gjyqësore/përmbarimore dhe kanë të bëjnë me kompensimin e pagave jubilare dhe përcjellëse me rastin e pensionimit të punonjësve. Po ashtu nga investimet kapitale janë paguar 22,190€ për mallra dhe Shërbime. Edhe këto pagesa janë paguar nga Thesari sipas vendimeve gjyqësore dhe kishin të bënin me borxhet ndaj furnitorëve të ndryshem.<br>*Komuna kishte kryer pagesa nga kategoritë ekonomike jo adekuate përmes planifikimit të gabuar, si:<br>*Nga mallrat dhe shërbimet janë paguar 51,340€ për subvencione dhe transfere. Pagesat kishin të bënin me mbulimin e shpenzimeve të varrimit;<br>*Nga mallrat dhe shërbimet janë paguar 13,444€ për shpenzime kapitale. Shpenzimet kanë të bëjnë me kontraten „Rregullimi i sallës së bibliotekës dhe furnizimi me inventar për bibliotekën –Fehmi Lladrovci";<br>*Nga investimet kapitale janë paguar 36,406€ për mallra dhe shërbime. Shpenzimet ishin sipas | Kryetari duhet të sigurojë që janë ndërmarrë të gjitha veprimet që shpenz-nzimet të planifikohen në ndarjet adekuate të buxhetit (apo të ridestinohen mjetet kur është e nevojshme dhe e mundshme) dhe që pagesa e regjistrimi i shpenzimeve bëhet në menyrë strikte sipas kodeve ekonomike adekuate. | Me rastin e planifikimit të buxhetit komunal për vitin fiskal 2021, është bërë planifikimi i shpenzimeve sipas ndarjeve adekuate, pasi kufiri i kategorive ekonomike të shpenzimeve ka lejuar një gjë të tillë. Pagesat dhe regjistrimi i shpenzimeve është duke u bërë në menyrë strikte sipas kodeve ekonomike. | Ky rekomandim është i zbatuar. | Sfidë për zbatimin e këtin rekomandimi paraqesin kufit e imponuar për kategori ekonomike të shpenzimeve nga MFT. |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | kontratave „Inventarizimi në shkolla" pagesa prej 34,956€ si dhe „Blerja e mjeteve të teknologjisë" pagesa prej 1,450€. Po ashtu nga investimet kapitakle ishin paguar 6,811€ për subvencione në bujqësi. Këto kanë ndodhur për shkak të planifikimit të dobët të buxhetit nga ana e komunës dhe aprovimit nga MF dhe Kuvendi I Republikës së Kosovës. | | | | |
| 2 | B 2 | **-Mangësi në procedurat e rekrutimit.**<br>Në konkursin publik të datës 07.11.2019 për rekrutimin e një „Mësimdhënësi për arsimfillor" në shkollën Bajram Curri në Nekoc, kemi identifikuar disa mangësi:<br>*Kandidati i cili është shpërblyer me kontratë, ka arritur të marrë pikët e mjaftueshme për të kaluar pragun e nevojshëm për 50% vetem pasi ishte mbivlerësuar nga komisioni në testin me shkrim, deri sa kundër kandidatët ishin nënvlerësuar nga komisioni në disa pyetje. Po ashtu i njëjti nuk e kishte përvojën e punës të kërkuar me konkursin publik;dhe disa prej dokumenteve të komisionit vlerësues nuk ishin të nënshkruara nga kryetari komisionit vlerësues.<br>Kjo gjendje ishte për shkak se komisioni nuk kishte rrespektuar kërkesat ligjore dhe kriteret e konkursit publik si dhe nuk kishte vlerësuar drejtë të gjithë kandidatet pjesëmarrës në këtë konkurs. Ndërlidhur me çështjen e vlerësimit të testit me shkrim, komisioni vlërsues është arsyetua se në disa raste ka kandidat të cilët janë stimuluar me qëllim të motivimit dhe dhënies së mundësisë së intervistimit. | Kryetari duhet të sigurojë se janë zbatuar më perpikri kërkesat ligjore në proceset e rekrutimit të stafit, në mënyrë që të ketë trajt-im të barabartë të kandidatëve dhe të pranohen kandidatë meritor në bazë të kualifikimeve, përvojës dhe arritjeve në test dhe në intervistë. | Procedurat e rekrutimit tash e tutje janë duke u zbatuar plotësisht pa pasur lëshime të natyrës së ngjajshme. Dëshmi kemi disa procedura të rekrutimit. | I zbatuar. | //// |
| 3 | A 1 | **-Dobësi në procesin e planifikimit të prokurimit.**<br>Komuna gjatë vitit 2019, ka zhvilluar tri procedura të prokurimit për natyrën e njëjtë të furnizimit | Kryetari duhet të sigurojë që njësitë kërkuese parashikojnë | Zyra e Prokurimit ka dërguar planin preliminar në ZKA, dhe pastaj të | Pjesërisht i zbatuar. | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | „Furnizim ushqim dhe pije për nevojat e QEAB Ardhmëria". Si rezultat janë lidhur tri kontrata me vlerë totale prej 26,060 €. Ndërsa për këtë të prokurimit komuna ka paraparë në planifikimin e prokurimit një aktivitet për vitin 2019 në vlerë prej 10,000€.<br>Kjo gjendje ishte për shkak të planifikimeve jotë sakta të njësisë kërkuese në kontratën e parë e cila ishte lidhur për një periudhë tre mujore. Si rezultat, komuna ishte detyruar të nënshkruante aneks kontratë sipas procedurës së negociuar pa publikim të njoftimit për kontratë, tutje kontrata e tretë ishte lidhur për të mbuluar nevojat e qerdhes për furnizimet me ushqim dhe pije për një periudhë një vjeçare. | në menyrë më të saktë nevojat për furnizime vjetore dhe në bashkp-unim me departamentin e prokurimit të bëjnë një planifikim të prokurimit duke zbatuar kërkesat ligj-ore. | njësitë kërkuese përmes emailit, ku kemi kërkuar që për çdo ndryshim-plotësim apo sqarim lidhur me planin preliminar nga njësitë kërkuese të i dorëzojnë në Zyrën e Prokurimit para se të dorëzohet për në AQP. | | |
| 4 | B 3 | **-Mungesa e projektit ekzekutues.**<br>Kemi identifikuar se në 23 kontrata pune komuna nuk kishte hartuar projektin ekzekutues, por i kishte zhvilluar procedurat e prokurimit duke përgatitur vetem paramasën dhe parallogarinë. Mungesa e projekteve ekzekutuese kryesisht ishte tek ndërtimi i kanalizimeve, rrugëve, dhe infrastructures tjeter.<br>Komuna kishte kontratë me një operator për hartimin e projekteve, mirë po nuk ishte e kënaqur me cilësin e projekteve të marra nga operatori, prandaj procedurat e prokurimit janë zhvilluar vetëm me paramasë dhe parallogari. | Kryetari duhet të sigurojë se për të gjitha aktivitetet e prokurimit hartohen specifika dhe kushte të qarta për të siguruar ekonomic-itetin/efikasitetin dhe efe-ktivitetin e blerjeve të rea-lizuara. Po ashtu, të gjitha procedurat që kanë të bëjnë me punë të mos inicohen pa u siguruar specifika të qarta sipas projektit ek-zekutues. | Drejtorati i Infrastrukturës Publike ka dhënë detyrat projektuese për disa projekte ekzekutuese, ndërsa disa projekte tjera kishin projekte ekzekutuese dhe u realizuan sipas projektit ekzistues. | Pjesërisht i zbatuar. | //// |
| 5 | A 2 | **-Mangësi në procedurat e prokurimit.**<br>Te aktiviteti i prokurimit „Ndërtimi i rrugës Vuqak-Tërdec (projekt tre vjeëar) i cili ka rezultuar me | Kryetari duhet të sigurojë se stafi i caktuar në mena- | Pas marrjes së rekomandimeve mga auditorët, Zyra e | I zbatuar. | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | kontratë prej 328,641€, bazuar në procesverbalin e hapjes kemi evidentuar se çmimi i ofertës më të lirë ishte 310,110€. Megjithatë, kjo ofert ishte eliminuar për shkaqet e paraqitura në „Letren standard për tenderuesin e eliminuar", e që kishin të bënin me mungesën e dokumentacionit në tenderin në fjalë, mirëpo sipas kërkesave ligjore të gjitha këto dokumente mund të kërkoheshin gjatë procesit të vlerësimit përmes sqarimit të tenderëve ose nuk ishin kërkuar fare në njoftimin për kontratë/dosjen e tenderit.<br>Kjo gjendje isht për shkak të mungesës së njohurive lidhur me kërkesat ligjore për ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e tenderve. | xhimin e procedurave të prokurimit janë në njohuri me kërkesat rregullative ligjore për prokurimin publik dhe se aplikojnë kontrollet në të gjitha fazat e tij. | Prokurimit ka filluar përmesë shkresave standarde (Formularit B47) duke u kërkuar sqarime me plotësimin e dokumenteve OE,si psh në projektet më poshtë:<br>1.Furnizimin e fermerve me centrifugë mekanike për bletari,<br>2.Furnizimi me materjal higjenik mbrojtës nga viruesi Covid-19, për Sektorin e Arsimir,<br>3.Renovimi dhe mirëmbajtja e objektit të SHZSH-së në Gllobar,<br>4.Blerja e kontenjerve dhe shportave për mbeturina-faza e dytë. | | //// |
| 6 | A 3 | **-Pagesë për punë të pakryera.**<br>Te kontrata e dt. 27.12.2019 për „Ndërtimin e kolektorëve për grumbullimin e ujrave tëzeza në Komunën e Drenasit " LOT 1 në vlerë 229,120€, kemi vërejtur se vetëm 3 ditë pas nënshkrimit të kontratës (30.12.2019) ishte realizuar pagesa prej 132,090€ (57% e vlerës së kontratës) për furnizimin e gypave sipas pozicioneve 6.1:6.1.1;6.1.2 dhe 6.1.3. sipas raportit të menaxherit të kontratës dhe organit mbikëqyrës kishte ndodhur vetëm furnizimi i gypave por jo edhe montimi ashtu siç parashihet në pozicionin 6.1 të paramasës . Mirëpo, bazuar në deshmitë e siguruara (foto të gypave dhe deklaratën e OP) kemi vërtetuar se nuk kishte ndodhur as | Kryetari duhet të sigurojë se menaxheret e kontratav dhe organi mbikëqyrës aplikojnë kontrolle efektive në menaxhimin e kontrat-ave dhe pranimin e furniz-imeve /punëve si dhe pa-gesat bëhen vetëm për fu-rnizimet/punët e realizua-ra. | Tek kontrata „Ndërtimi i kolektorve për grumbullimin e ujrave të zeza në Komunën e Drenasit" LOT-1 është realizuar projekti sipas planifikimit dhe është bërë pranimi teknik. | I zbatuar. | //// |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | furnizimi.<br>Sipas zyrtarëve të komunës, pagesa ishte realizuar për të mos lejuar që mjetet të shkonin në suficit. Duhet theksuar se gjatë kohës sa ishim në auditim (fillimi i korrikut 2020) ky projekt ishte në process të pranimit teknik. | | | | |
| 7 | A 4 | **-Tejkalimipozicionevetëkontratëspublikekornizë.**<br>Tekontratapublikekornizëpër „Mirëmbajtjen e ndriçimitpublik" prej 43,333€ kemiverifikuar se në 4 pozicionekishtetejkalimmbi 30% e lejuartësasivetëkontraktuara, kjonukkandikuarnëtejkalimin e vlerëstotale indicative tëkontratës. Poashtu, tekjokontratënukështëpërdorurshablloni i kontratëskornizësipasdosjes se tenderitpërkontratatkornizëdhenuk e kaspecifikuar se lejohetdevijimi +/-30%.<br>Kjogjendjeishtepërshkaktëneglizhencëssëzyrëssëprokurimitgjatëmenaxhimit me procedurat e prokurimitdhehartimittëkontratave. | Kryetari duhet të sigurojë që kontratat e nënshkruara të përmbajnë çmimet e sakta dhe devijimet e lejuara si dhe të kërkojë nga zyrtarët përgjegjës që mos t ë tejkalohen devijimet përtej limiteve të devijimit të përcaktuara me kontratën publike kornizë. | Pas marrjës së rekomandimeve mga auditorët Zyra e Prokurimit, ka filluar të përdorë shabllonin e kontratës kornizë duke e specifikuar në kontratë se lejohet devijimi +/-30% si në këto raste:<br>1.Furnizimi me materjal pedagogjik dhe Didaktik për Instituciont Arsimore-projekt tre vjeqar,<br>2.Grumbullimi, transporti dhe asgjesimi i mbeturinave medicinale nga shërbimet shëndetësore,<br>3.Mirëmbajtja e rrugëve gjatë dimrit. | I zbatuar | ///// |
| 8 | B 4 | **-Vonesa në realizimin e furnizimeve/punëve.**<br>Në tri pagesa kemi hasur në vonesa në liferimin e furnizimeve si dhe nuk janë aplikuar ndëshkime/ penale të përcaktuara në kontratë, si:<br>*Te pagesa në vlerë 10,800€ për kontratën „Furnizim me dru zjarri (bungu&qarri) për nevojat e institucioneve arsimore dhe shëndetësore Drenas", vonesat në dorëzimin e furnizimeve të druve ishin | Kryetari duhet të sigurojë kontrolle shtesë të monitorimit në mënyrë që të gjitha furnizimet dhe punët të pranohen sipas kushteve të kontraktuara, dhe në rastet e pa | Gjatë vitit 2020 ju ka kushtuar kujdes më i madh sa i përket realizimit të projekteve në kohen e paraparë. Vendimet e | Pjesërisht i zbatushem | Në vitin 2020 buxheti është aprovuar me vonesë. |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | nga 46 deri 62 ditë, vonesat ishin për shkak të pa përgjegjëshmerisë së OE;<br>*Te pagesa në vlerë 7,561€ për kontraten „Furnizim me materjal shpenzues mjekësor dhe ampula", vonesat ishin 10 ditë, vonesat ishin përshkak të menaxhimit jo adeku-at të kerkesave për furnizime, dhe<br>*Te pagesa në vlerë 2,712€ për kontratën „Furnizim me artikuj-material elektrik, veglari dhe llaqe, artikujt e sanitarisë dhe artikuj bujqësorë", vonesat ishin 16 ditë mbi afatin e përcaktuar 3 ditor të kontratës, vonesat ishin për shkak të menaxhimit jo adekuat të kërkesave për furnizime.<br>Vonesa në realizim kemi identifikuar edhe në dy kontrata të punës. Vonesat ishin raportuar nga menaxheret e kontratave dhe nuk ishin të arsyetuara, mirëpo nuk ishin aplikuar penale/ndëshkime për këto vonesa, si:<br>*Te kontrata „Ndërtimi i depove për lëndë djegëse në shkolla" prej 44,918€, vonesat ishin 40 ditë; dhe<br>*Te kontrata „Rrethojat e fushave sportive për shkolla" prej 57,351€, vonesat ishin 44 ditë. | justifikuara të vonesave në liferim të ma-llit/kryerje të punëve, të aplikohen ndëshkimet e përcaktuara me kontratë. | nxjerrura nga niveli qendror për ndalimin e punëve të disa sektoreve ka ndikuar edhe në komunën tonë. | | Gjatë shpenzimit të buxhetit në këtë vit, për shkak të Pandemisë covid – 19, ka pasur shuëmVendime nga Qeveria të cilat e kanë ndaluar punën e operatorëve ekonomikdhe në këtë mënyrë kanë ndikuar që edhe realizimi i projektev e të mos mund të kryhet gjithëher |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | e në kohen e paraparë. |
| 9 | B 5 | **-Shpenzime të larta procedurale të pagesave të ekzeku -tuara sipas vendimeve gjyqësore.**<br>Ne kemi identifikuar se Thesari kishte ekzekutuar në bazë të vendimeve gjyqësore pagesa në vlerë 600,322€. Kjo formë e pagesave, përveq ndikimit në keqklasifikimin e shpenzimeve (që është trajtuar tek opinjoni i auditimit) , ka ndikuar edhe në rritjen e shpenzimeve, ngase borxhi kryesor ndaj pretenduesve ishte 416,618€, ndërsa shpenzimet procedural të përmbarimit ishin 183,704€.<br>Pagesat kishin të bëjnë kryesisht me detyrimet e dala nga marrëveshja kolektive për kompensimin e tri pagave jubilare dhe tri pagave përcjellëse me rastin e pensionimit të punonjësve, borxhe të pa paguara ndaj furnitorve si dhe për çështje të problemeve pronësore.<br>Arsyet e pagesave të tilla vijnë si rezultat i planifikimit të dobët dhe mungesës së buxhetit nga programet përkatëse për këto raste. | Kryetari duhet të sigurojë bashkpunim me MF ashtu që obligimet që dalin nga marrëveshja kolektive të planifikohen /buxhetohen dhe paguhen në kohën e duhur nga kategoria e pa-gave dhe mëditjeve. Gjithashtu obligimet të paguhen brenda afateve kohore të parapara ligjore sipas LMFPP. | Gjatë vitit që shkojë kemi mbajtur takime me ZKA-në, MFT, dhe Asociacionin e Komunave, ku kemi kërkuar që për kontratat kolektive të merret niveli qendror, dhe për këtë presim veprime konkrete nga niveli qendror.<br>Në vitin 2020, pagesat e pagave jubilare dhe përcjellse po realizohen përmes listës së pagave, si deshmi është aktvendimi i datës 8.07.2020.<br>Në këtë vit kemi arritur që këto shpenzime të jenë katër here më të vogla se sa në vitin 2019. | Pjesërisht i zbatueshem. | Caktimi i kufijve buxhetor nga MFT-ja është sfida për t'a zbatuar këtë rekomandim. |
| 10 | A 5 | **-Ndryshime në pozicionet e kontratave pa aprovimin paraprak të ZKA-së.**<br>Gjatë testimit të pagesave ne kemi identifikuar 14 kontrata në të cilat kishte pasur devijime apo ndryshime të sasive të realizuara nëpër disa pozicione, duke rritur /zvogluar sasinë e kontraktuar, apo në disa raste duke mos realizuar fare pozicionet e kontraktuara, por pa rritur çmimin total të kontratës. Për këto ndryshime nuk ishin marrë aprovimet e nevojshme nga zyra e prokurimit dhe nga ZKA ashtu siç kërkohet me nenet 61.22 dhe 61.23 të RrUOPP. | Kryetari duhet të sigurojë se çdo ndryshim në kushtet e kontratës para ose gjatë periudhës së zbatimit do të bëhet vetëm pas njoftimit të zyrës së prokurimit dhe marrjes së aprovimit nga zyra e prokurimit dhe ZKA konform procedurave | Gjatë vitit 2020 asnjë ndryshim në termat e referencës në kontratat e nënshkruara nuk është bërë pa aprovimin e ZKA-së.<br>Drejtorati i Infrastrukturës Publike ka aplikuar këtë aprovim në projektet:<br>1.Kanalizimi i ujërave të zeza në Fshatin Terstenik I | I zbatueshem. | //// |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | Prej tyre, duhet theksuar ndryshimet realizimin e pozicioneve në tri kontrata:<br>*Te kontrata „Infrastruktura në fshatin Abri e Epërme dhe Tërdec" me vlerë 48,498€, ndryshimet ishin të shprehura në pozicionet e punimit të tubave atmosferike të cilat nuk ishin punuar sipas kontratës, përkatësisht të segmenti i parë nuk janë gypat fi 600 dhe fi 400 të cilit ishin të kontraktuar, por janë vendosur gypa fi 315 që nuk ishin fara të kontraktuar (ky pozicion i shtuar nuk ka kaluar nëpër procedura të prokurimit), po ashtu edhe në dy segmented tjera në vend gypave fi 800, fi 600 janë vendosur gypa fi 400. Këto ndryshime nuk janë pranuar nga menaxheri i kontratës dhe organi mbikëqyrës dhe nuk janë paguar si pozicione, ndonse pranimi teknik është bërë me këto ndryshime. Po ashtu duhet theksuar se çmimet e kontraktuara për gypat dhe disa pozicione tjera ishin jo normalisht të ulëta (gypi fi 800 ishte kontraktuar 10 cent, gypi fi 600 dhe fi 400 ishin kontraktuar vetem 1 cent);<br>*Te kontrata „kanalizimi i ujrave të zeza në fshatrat Baicë, Krajkovë, Shtuticë dhe Verbovc" në vlerë 74,601 €, përveç rritjes dhe zvoglimit të sasive në disa pozicione, ishte shtuar një pozicion prej 760€ (pa procedure të veçantë të prokurimit) i cili nuk ishte fare në paramasen e kontraktuar;<br>*Ndryshim të sasive në disa pozicione kemi identifikuar edhe te kontrata „Asfaltimin e rrugëve të fshatrat Poklek i ri, Poklek i vjetër , Vasilevë Korroticë e poshtme dhe e Eperme, Zabel i poshtëm dhe i Epërm" në vlerë 81,300 €. Duhet theksuar se në të gjitha segmentet e rrugëve që janë paraparë të asfaltohen me këtë kontratë, pozicionet që kanë të | të parapara me ligjin dhe rregullat e prokurimit. | dhe II.<br>2.Kanalizimi i ujërave të zeza Dobroshec-Qikatovë e Vjatër,<br>3.Kanalizimi i ujërave të zeza Gllanasellë dhe Godanc,<br>4.Rregullimi i ndriqimit publik në Komunën e Drenasit,<br>5.Kanalizimi i ujërave të zeza në Fshatin Nekoc dhe Kizhnarekë,<br>6.Lot-2 Ndërtimi i kolektorëve të ujërave të zeza në Terstenik, Verbovc dhe Shtuticë,<br>7.Ndërtimi i urave dhe tombinave dhe murit mbrojtës,<br>8.Asfaltimi i rrugëve n8.Asfaltimi i rrugëve në Fshatin Poklek i ri -Poklek i Vjeter, Vasilevë, Sankoc, Fushticë e Ulët, Fushticë e Eperme, Zabeli i Ulet, Zabel i Eperm dhe Korroticë e Eperme. | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | bëjnë me punët e dhevt janë kontraktuar çmime jo normalisht të ulëta dhe zyra e prokurimit nuk e kishte trajtuar sipas „Rregullave për tenderët jo normalisht të ulët" gjatë procedurave të vlerësimit të tenderëve.<br>Nevoja për ndryshime kishte ardhur përshkak të disa arsyeve si: mungesës së projekteve ekzekutive, problemeve pronësore, specifikave të punëve, konfiguracionit të terenit ku realizohen punimet si dhe për t'i bërë projektet më funksionale. Ndërsa mos aprovimi i këtyre ndryshimeve ka ndodhur për shkak se menaxheret e projektev nuk ishin në njohuri për kërkesat ligjore të prokurimit publik lidhur me ndryshimin e kontratave. | | | | |
| 11 | B 6 | **-Mangësi në regjistrin kontabel të pasurive.**<br>*Neni 6.3 i Rregullores për 02/2013 për menaxhimin e pasurive jo financiare kërkon që pasuria kapitale duhet të regjistrohet në SIMFK, ndërsa pasuria jo kapitale dhe stoqet duhet të regjistrohet në sistemin E-pasuria. Në tri raste, pagesat për blerjen e pasurive kapitale dhe jo kapitale në vlerë 48,197€ nuk ishin regjistruar në regjistrin e pasurive brenda vitit 2019 (prej tyre një pagesë me vlerë 11,791€ e cila është regjistruar në SIMFK, në vitin 2020 dhe 2 pagesa prej 36,406€ nuk ishte regjistruar në e-pas)<br>*Te projekti për „Rregullimin e garazhave për mjetet e shërbimit të zjarrfikësve" kemi evidentuar se regjistrimi i pasurisë ishte bërë gabim, ngase regjistrimi ishte bërë sipas pagesave totale që ishin bërë prej 45,991€, ndërsa është dashur të regjistrohej sipas vlerës së punëve të kryear prej 47,316€.<br>*Komuna ka kryer procesin e inventarizimit të pasurive jo financiare, mirëpo nuk është bërë krahasimi i gjendjes së inventarizuar me gjendjen në | Kryetari duhet të sigurohet se të gjitha pasuritë e komunës janë identifikuar dhe regjistruar saktë në re-gjistrat përkatës të pasurive komunale. Po ashtu duhet siguruar se është bërë krahasimi i gjendjes së inventarizimit me gjendjen në regjistrat e pa- surive jo financiare dhe në PFV të shpalosen informatat e sakta rreth pasurive. | Në SIMFK-të gjitha pasuritë janë identifikuar saktë dhe janë marrë masat e duhura, kurse në e-pasuri ende nuk kemi mundur të evidentojm një gjendje të saktë,mirëpo janë marrë masat e duhura ne atë drejtim, për arsye se sistemi e-pasuria ka pasur ndryshime dhe ka ngecje nga agjencia përkatëse. | Pjesërisht i zbatuar. | Në Sistemin e-pasuri, sfidat janë nga jashtë (agjencioni kompetent) i cili s'pomundet t'a funksionalizojë sistemin. |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | regjistrat e pasurive jo financiare ashtu siç kërkohet me nenin 19.4.3 të Rregullores 02/2013. | | | | |
| 12 | C 1 | **-Inkasim i ulët i llogarive të arkëtueshme.**<br>Për kunder trendit të zvoglimit të llogarive të arkëtueshme në krahasim me vitin e kaluar, edhe gjatë vitit 2019 nuk kishte menaxhim efektiv në mbledhjen e tyre. Përkundër vërejtjeve ndaj tatimpaguesve mbi 1000€, pezullimin në disa shërbime komunale si dhe marrëveshjeve të nënshkruara mes tatim paguesve dhe komunës për shlyerjen e borxheve me këste, prapë ka një numër të konsiderueshëm të borxheve, për arkëtimin e të cilave nevojiten veprime shtesë.<br>*Nga 27 mostra të testuara në vlerë 403,132€ tek taksat në biznese, kemi konsideruar që shumica janë borxhe të vjetra, disa për biznese jo aktive, dhe kishte menaxhim të dobët të programit të taksave ndër vite. Komuna ende nuk ka aktivizuar softuerin e ri për menaxhimin e të hyrave/llogarive të arkëtueshme të taksave në biznes. Llogarit e menaxhuara në Exel, dhe të dhënat e prezantuara nuk japin siguri për saktësinë dhe plotësinë e tyre.<br>Të gjeturat e mësipërme janë shfaqur për shkak se komuna nuk kishte ndërmarrë të gjitha veprimet e mundshme dhe të mjaftueshme për inkasimin e të hyrave nga borxhet e paraqitura në llogaritë e arkëtueshme. | Kryetari duhet të sigurojë efikasitet më të lartë në arkëtimin e llogarive të ark-ëtueshme. Hartimi dhe aplikimi i programeve dhe procedurave të qarta për mënyrën e menaxhimit dhe arkëtimit të tyre, do të ndihmonte në këtë drejtim | **Hapi 1.**Rekomandimet për llogarit e arkëtueshme dhe për këtë periudhë, mbesin pjesërisht të zbatuara. Për zbatimin e këtyre rekomandimeve në vazhdimësi mbesin hapat e ndërmarrë si vijon:<br>-Pezullim i shërbimeve komunale për tatimpagues që kanë borxhe nga tpr mbi 10€,<br>-Dërgimi i vërejtjeve për borxhet me lartësi mbi 1,000€,<br>-Lidhja e marrëveshjeve për pagesën e borxhit me këste prej 12 vetave,<br>-Verifikimi, paraprakisht i pronave që janë tatimuar dhe asnjëherë nuk është bërë pagesa e këtij tatimi, ku në disa prej këtyre rasteve, na kanë dalur si prona të dyfishuara, dhe mu për këtë ka reflektuar edhe të shuma e borxheve nga TPR-ja.<br>**Hapi 2**. Lidhur me arkëtimin e borxheve të vjetra të Taksa Komunale:<br>-Janë duke u zbatuar | Pjesërisht i zbatuar. | Sfidë për realizimi n e këtyre veprimev e edhe mëtutje do të mbetet pandemi a Covid-19. |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | marrëveshjet e lidhura paraprakisht në mesë të Komunës dhe OE,për kryerjen e pagesave. Për këtë periudhë të vitit fiskal 2020, llogaritë e arkëtueshme janë zvogluar për vlerën 94,575.00€.<br>-Sa i përket borxheve të bizneseve tjera jemi në përgatitjen e lëndve.<br>-Tani DZHE, ka aktivizuar softuerin e ri për menaxhimin e të hyrave/llogarive të arkëtueshme të taksave në biznes, dhe është duke përfunduar bartja e të dhënave nga kartelat e programit të vjetër në program të ri , i cili program ofron sktësi dhe korrektësi. | | |
| 13 | A 6 | **-Mbivlerësim i detyrimeve kontigjente.**<br>Gjatë testimit të detyrimeve kontigjente, ne kemi vërejtur që vlera 34,167€ ishte përfshirë dy herë në listen e detyrimeve kontigjente duke i mbivlerësuar ato.<br>Kjo kishte ndodhur si rezultat i komunikimit jo të mirë ndërmjet zyrës së financave dhe zyrës ligjore. | Kryetari duhet të sigurohet se zyra ligjore dhe e financave bashkëveprojnë në mënyrë sistematike për të siguruar shpalosje të plota dhe të sakta të detyrimeve kontigjente. | Veprimet e planifikuara në drejtim të zbatimit të rekomandimit nga ana e Auditorit janë paraparë të ndërmerren gjatë tre mujorit të fundit të vitit 2020, periudhë kjo kur edhe kërkohen këto shifra për të cilat është paraparë vigjilencë, kontrollë dhe | Tani për tani pjesërisht i zbatuar (jemi në vazhdimësi në komunikim me Avokaturën Shtetërore lidhur me përditësimin e | //// |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | diskutime më të hollësishme paraprake me zyrtarët kompetent në këtë drejtim në menyrë që të dhënat e ofruare të jenë sa më të sakta dhe pa mangësi eventuale që mund të paraqiten. | këtyre të dhënave), ndërsa zbatimi i plotë i tij pritet të realizohet gjatë tre mujorit të fundit të vitit 2020. | |
| 14 | A 7 | **-Mos kompletimi i NJAB-së.**<br>Neni 5.1.1 i Rregullores 01/2019 për themelimin e Njësisë së Auditimit të Brendshëm përcakton që çdo subjekti i sektorit publik me buxhet mbi 7 milion€ duhet të ketë së paku tre auditorë. NJAB në Komunën e Gllogocit përbëhet nga drejtori dhe një anëtar.<br>*Mos kompletimi i NJAB me staf të mjaftueshëm, mund të ndikojë që auditimi i brendshëm mos të mbulojë të gjitha fushat me rrezik, dhe t'i pamundësoj menaxhmentit marrjen e veprimeve me kohë për parandalim-in e gabimeve të mundshme. | Kryetari duhet të sigurojë se për pozitat e kërkuara do të bëhen planifikimet buxhetore me kohë dhe se Njësia e Auditimit të Bre-ndshëm do të plotësohet me staf të mjaftueshëm sipas rregullores në fuqi. | Me Planin Strategjik të NJAB-së për vitin 2021-2023, të aprovuar me dt. 08.12.2020, nga NJAB-i është kërkuar shtimi i numrit të auditorëve në vitin 2021, dhe është planifikuar me planin e personelit për vitin 2021.. | Pjesërisht i zbatuar. | Mos aprovimi i vendeve të lira të punës nga MAP, kufizimi i stafit dhe buxhetit. |